



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
ZYRA E KRYETARIT



Nr. 01.111-13574 dt. 11.03 2019

Në vështrim të nenit 58 dhe 68 paragrafi 68.3 të Ligjit nr.03/L-040, dhe nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Zyra e Kryetarit të Komunës bën këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E THIRRJES PUBLIKE PËR APLIKIM NR. 01-400-11295 E DATËS 27.02.2019

ANULOHEM, në tërësi thirrja publike për aplikim për subvencione me nr.01-400-11295 e datës 27.02.2019.

Me anë të këtij vendimi njoftohen të gjitha organizatat joqeveritare dhe akteret e tjerë, të sektorit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit se është anuluar thirrja publike për aplikim për subvencione me nr.01-400-11295 e datës 27.02.2019.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit.

Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Harmonizim i kriterëve, kushteve dhe procedurave për përfitimin e subvencioneve nga OJQ-të me rregulloren e nivelit qendror me nr.04/2017, rregullore kjo e cila nuk ka pasur zbatueshmëri të plotë deri më tani në nivel vendi, por që për zbatimin e saj na është kërkuar në nivel komunash edhe përmes takimit që kanë pasur të gjitha drektoritë që kanë kategorine buxhetore subvencione, me datën 07.03.2019 me zyrtarë të Kryeministrit dhe MAPL-së.

Drjtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shqyrtuar mundësinë e modifikimit të kësaj Thirrje Publike, por mëqense dallimet janë qënsore detyrohemi ta anulojmë.

Me anë të këtij njoftimi gjithashtu u kërkojmë falje të gjithë aplikuesve që kanë dorëzuar aplikacionin.

Në afatin sa më të shkurt kohor do harmonizojmë aspektin ligjor dhe do të publikojmë thirrjen publike për aplikim për subvencione.

Drenas, 11 mars 2019



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci